



**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



01/Nr. 6268 /2021  
Data: 24.08.2021

**PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS**

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.07.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Edon Curri (Drejtor i Administratës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se z.Florim Shkreta në pamundësi për pjesëmarrje në mënyrë fizike ju ka mundësuar që përmes sistemit elektronik zoom pjesëmarrja në mbledhje .

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026.
3. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021.
4. Raporti i auditorit të brendshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2020.
5. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm - 2020.
6. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
7. Informatë për raportin e përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
8. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.
9. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma thekson:-** plani lokal i veprimit në mjedis është shqyrtuar në komitet për politik e financa, në kuvend dhe në debat publikë. Gjatë procedurave nuk ka pasur ndonjë propozim për ndryshim.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** unë mendojë që Hani i Elezit është me specifikat tjera e jo si çdo komunë tjetër e jo të merret kopi pastë. Nuk ka diçka shumë konkrete dhe cilat janë ndryshimet të cilat ju keni bërë nga debati publik për shkak se nuk kam vërejtur diçka që keni ndryshuar. Sa ka hyrë në këtë draft trashëgimia kulturore.

**Sead Vila thekson:-** sa i përket popullsisë dhe vendbanime cila është ajo familje që është në fshatin Neqafc që është banuese rezidente dhe nëse është një familje që po mendojë unë është e tmerrshme për shkak të problemeve që po ju sjellë familjeve në komunitet. Është bërë një punë e madhe për hartimin e këtij draft plani. Në faqe 20 që është cekur trashëgimia kulturore por a nuk dihet se kur e ka zanafillën Xhamia e Vjetër se në cilin vit daton. Në draft plan ka disa terminologji që do të ishte mirë me i shpjeguar sepse nuk janë autoktone dhe janë të huazuara. Janë disa gabime drejtshkrimore që duhet të përmirësohen. Lagja nën hekurudhë nëse është në zonë kadastrale të Hanit të Elezit është mirë me emërtuar më ndryshe. Industria dhe bujqësi, kategoritë të cilat ceken me numër të njëjste pra do të ishte mirë me i cekë me numër sa industri apo sa toka bujqësore e jo vetëm me i përshkruar me një format të emërtimit. Në draft ishte përcaktuar edhe përbërja e mbeturinave për secilën kategori.

**Mallzum Qajani thekson:-** në debat me qytetar që kemi pasur nuk është dhënë ndonjë propozim. Trashëgimia kulturore është pjesë e veçantë që duhet të trajtohet dhe në këtë plan janë trajtuar sendet të cilat kanë ndikim në forma të ndryshme dhe aktivitet që janë planifikuar për me u zhvilluar. Shënimet për familjet rezidente merren nga agjensioni i statistikave të Kosovës dhe regjistrimi në vitin 2011, e në atë vit dikush është regjistruar dhe shënon që në fshatin Neqafc është një familje e cila i ka katër anëtarë. Dokumenti ndoshta ka disa gabime gjuhësore por si dokument është i qëndrueshëm .

**Mehmet Ballazhi thekson:-** trashëgimia kulturore ka ndikim në mjedis sepse hynë edhe arkeologjia dhe ne e dimë se në çfarë niveli është zhvillimi i arkiologjisë te na. Te trashëgimia kulturore nuk pashë asgjë konkrete.

**Mallzum Qajani thekson:-** ky plan i paraqet problemet që shkaktohen në mjedis dhe këto probleme që janë identifikuar dhe potencialisht mund të ndikojnë në mjedis janë munduar që përmes aktiviteteve ose të kenë efekt më të vogël ose të eliminohen. Trashëgimia kulturore në plan të mjedisit sipërfaqësisht përmendet por nuk është domen i trajtimit.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** nuk është mirë të potencohet në mënyrë sipërfaqësore sepse është plan për shkak se nuk jemi tu bërë ese këtu dhe me shënuar se me çka identifikohet Hani i Elezit por është plan lokal i veprimit për ndikim në mjedis dhe për atë është dashur me detalisht me u paraparë planifikime për projektet e realizimit qoftë në trashëgimi kulturore, qoftë në ujëra , qoftë në bujqësi për shkak se këtu përmendet bujqësia dhe zhvillimi ekonomik .

**Teuta Shkreta thekson:-** më herët kam propozuar te pishat në Gorancë të përcaktohet një vend për dhezjen e zjarreve, të vendoset një tabelarë dhe të dërgohet uji në atë pjesë. A keni zhvilluar ndonjë takim me kompaninë që operon në atë pjesë sepse është zotuar para neve që do të kontribuonë në atë pjesë.

**Zaim Bela** thekson:- çështjen e ujit në atë pjesë e kemi diskutuar disa herë sepse është pak problem por vetëm me shpim mund të bëhet por duhet të kemi mjete financiare. Në të ardhmen si zona të mbrojtura janë pishta në fshatin Neqafç dhe pishat në fshatin Gorancë. Kemi biseduar për këtë çështje me kompaninë por fillimisht duhet të dërgohet rryma në atë pjesë e pastaj të bëhet shpimi i pusit për ujë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për, 1 kundër z.Mefail Suma (nga grupi parlamentarë Nisma), 4 abstenim z.Mehmet Ballazhi, z.Florim Shkreta, znj. Besarta Suma ( nga grupi parlamentar i PDK-së) dhe z.Sead Vila (i pavarur).

#### U MIRATUA PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2021

### 3. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2021 është në shumë prej 2,520,165.91 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,684,502.11 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 810,386.79 € apo 49.10 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 157,735.16 € apo 44.66 %, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 25,274.42€ apo 37.72 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 33,885.00 € apo 42.20%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 154,053.92 € apo 32.19 % dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021 është në shumë prej 1,181,335.29 € apo 44.01 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 192,512.10 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Qershor 2021 apo 66.70% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje më shumë për 63,395.90 € apo 49.10%.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kur janë bërë planifikimet buxhetore kemi dhënë vërejtjet tona sepse nuk po planifikohen mirë projektet dhe shihet te shpenzimet për mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 157,735.16 €, ndërsa në shërbime kapitale është në shumë 154,053.92 €. Do të thotë se më shumë ka shpenzime për mallra dhe shërbime se sa shpenzime kapitale që të lenë me kuptuar që planifikimet buxhetore për këtë vit nuk i përshtaten nevojave të qytetarëve.

**Habib Thaçi** thekson:- ndërtimi i objektit të shtëpisë së kulturës është bërë mirë por pamja e parë që më ra në sy është dyert e hyrjes dhe kërkoj të ridizajnohet një model tjetër.

**Sead Vila** thekson:- duke pasur parasysh që është vit zgjedhorë a është menduar mirë për mjetet e planifikuara për gjashtë mujorin e dytë kur dihet se edhe dy muaj janë zgjedhjet.

**Mallzum Qajani** thekson:- është e natyrshme që në gjashtë mujor ka më shumë shpenzime në mallra dhe shërbime se sa në investime kapitale për shkak se shpenzimet kapitale paguhen pasi te realizohet projekti. Me që për investimet kapitale procedurat e prokurimit zhvillohen pas muajit mars projektet kryhen në muajin gushtë dhe në muajt në vijim. Dyert e shtëpisë së kulturës do të ndërrohen sepse këto janë vendosur për mos me u dëmtuar deri sa të kryhen punimet. Është e vërtet që është vit zgjedhor por procedurat vazhdojnë sikur në vit normal pavarësisht përbërjes së ekzekutivit, komuna i përfundon procedurat në mënyrë normale deri në fund të viti kalendarik.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte 10 për, 3 kundër, z.Mehmet Ballazhi, z.Florim Shkreta, znj. Besarta Suma ( nga grupi parlamentar i PDK-së).

#### U MIRATUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2021

#### **4. Raporti i auditorit të brendshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari thekson:-** këtë auditim e ka kryer Ministria e Financave departament i auditimit të brendshëm sepse siç dihet auditor të brendshëm nuk kemi. Bazuar në rregulloren 01/20219 subjekti që ka më pak se tre milion buxhet funksionin e auditimit duhet ta kryen në mënyra të tjera dhe jemi detyruar me bërë kërkesë në Ministri të Financave –Departamentit të auditimit dhe kërkesa është aprovuar. Departamenti i auditimit të brendshëm e ka bërë auditimin për buxhetin e viti 2020 si dhe për periudhën Janar-Mars 2021. Bazuar në këtë auditim që është bërë ne kemi një rekomandim i cili ka të bëjë me subvencionet se duhet të monitorohen, të kërkoet raporti nga përfituesit, formati i marrëveshjeve mos të përdoret shabllon por varësisht nga kërkesa e aplikuesit të dihet qartë qëllimi i përfitimit dhe afati i marrëveshjes.

**Habib Thaçi thekson:-** përfituesit përveç që kanë me raportuar është mirë që me ju bërë ftesë për me dorëzuar një raport për të gjitha shpenzimet dhe me raportuar në detaje se ku i kanë shpenzuar mjetet financiare .

**Mehmet Ballazhi thekson:-** te marrëveshja shabllonë a ka pasur disa raste apo ka qenë një rast i veçantë që auditori e ka parë si gjetje. Ata që i potencojë parafolësi ishin shqetësime të më hershme.

**Nora Xhoni thekson:-** ata të cilët janë përfitues a kanë ndonjë afat kohorë që e përcakton se për sa kohë duhet t'i paraqesin shpenzimet në komunë.

**Shabi Rexhallari thekson:-** auditorët i kanë marr 13 mostra dhe vitin e kaluar në muajin tetor janë shpërndarë 15000 € që përfitues ishin disa OJQ dhe e kemi pasur shabllon që secila OJQ e cila ka marr subvencione afatin ja kemi përcaktuar 12 muaj. Auditorët kanë potencuar që në momentin që epet subvencionin duhet të parashikohen në plan për sa kohë ka me kryer aktivitetin dhe mos me ja përcaktuar për 12 muaj. Për klubet sportive i kemi raportet por kjo ka të bëjë me OJQ e tjera e jo me klubet sportive. Pasi që ka qenë vit i pandemisë nuk kanë mundur me i kryer aktivitetet dhe kanë pasur afat deri në muajin tetor të këtij viti për me i realizuar dhe pastaj i sjellin raportet . Komuna do ta bënë një komision për verifikimin e aktiviteteve dhe besoj që brenda këtij viti do të rregullohet.

**Kryesuesi thekson:-** a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

#### **5. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm - 2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari thekson:-** pasi që e kemi rekomandimin menaxhmenti ka bërë një veprim të aktiviteteve që duhet me filluar . Datat janë përcaktuar se ne çfarë kohe mund të përfundon kjo.

**Habib Thaçi thekson:-** a ka ndonjë plan konkret për shpenzimet dhe a monitorohen se deri në afat të caktuar kanë me u shpenzuar se do të thotë që ende OJQ i kanë mjetet financiare në llogari. A është formuar ndonjë komision që do t'i monitoron këto aktivitete .

**Shabi Rexhallari thekson:-** komisioni është formuar por ende nuk e ka filluar monitorimin.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** subvencionet në bletari a janë subvencionuar në mënyrë individuale a si shoqatë e bletarisë

**Zaim Bela** thekson:- për fermerët individual nuk është kërkuar raport . Subvencionet në bletari i janë dhënë shoqatës së bletarëve në vlerë prej 2000 € dhe shoqata e bletarëve ka paraqitur raport për shpenzimin e mjeteve. Për këtë vit bletarët janë ndihmuar nga “Labi”.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

#### **6. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- praktikat e viteve të kaluara kanë qenë që KPF të jetë si grup punues dhe përveç KPF-së i kemi edhe dy anëtarë kemi diskutuar me qenë pjesë të komisionit z.Mefail Suma nga subjekti politik Nisma dhe z.Sead Vila si këshilltarë i pavarur në asamblenë komunale. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në KPF u dakordua që pjesë e grupit punues të jetë edhe z.Mefail Suma nga subjekti politik Nisma dhe z.Sead Vila si këshilltarë i pavarur në asamblenë komunale në mënyrë që të përfshihen me një far forme të gjitha forcat politike për me dhënë kontributin e tyre.

**Sead Vila** thekson:- edhe vitin e kaluar isha pesë e grupit punues dhe nëse e shihni të arsyeshme jam i gatshëm me kontribuar me idetë e mia në këtë plan.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022**

#### **7. Informatë për raportin e përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- në fund të viti 2019 është miratuar plani i integritetit dhe drejtorja e administratës si bartëse e këtij dokumenti strategjik është e obliguar me raportuar lidhur me përmbushjen e këtij plani. Është formuar grupi punues dhe ka përgatitur raportin duke u bazuar në planin e integritetit. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

#### **8. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- këshillit komunal për siguri në bashkësi mbanë mbledhje të rregullta në periudha mujore dhe diskutohet çështja e sigurisë . Në çdo muaj është diskutuar për sigurinë në komunë, çështja e koronavirusit, problemet te kufiri, problemet të cilat kanë ndodhur me grupin e të rinjve . Po ashtu janë trajtuar edhe tema të tjera të cilat i keni në material dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- problem emergjentë është çështja te kufiri. Dje ishte një periudhë e shkurtër që policia ka mbajtur rend dhe nuk ka pasur asnjë problem . Duhet të bëhet përpjekje me policin që me gjetur zgjidhje për shkak se tash janë mërgimtarët dhe duhet të gjendet një zgjidhje.

**Teuta Shkreta** thekson:- çështjen te kufiri e kemi diskutuar shumë herë edhe pse është shumëfishuar sepse edhe pjesa e Tetovës është tu lëviz në këtë pjesë. Duhet ta bëjmë më të madhe në nivel qendrorë këtë çështje në mënyrë që në këtë gjendje mos të na zenë sezoni dimërore.

**Habib Thaçi** thekson:- pasi policia nuk mund ta zgjidhë këtë problem, është mirë me shikuar alternativa tjera përmes ndonjë kompanie të sigurimeve që me i angazhuar dy persona për këtë çështje. Është mirë që të shikohen mundësit që të bëhet një nënkalim te çerdhja për nxënësit e Lagjes Brava dhe Lagjes Meliq.

**Mallzum Qajani** thekson:- problemi te kufiri është shumë i madh që i kalon mundësit dhe fuqitë e komunës për ta zgjedhur sepse duhet të merret tokë për zgjerim. Tok te kufiri është shumë e shtrenjtë dhe eksproprijimi i tokës me mjete të komunës do t'i kushton viti kalendarik për investimet kapitale. Premtime kemi nga Ministria e Financave që do ta rregullon atë pjesë. Ne kemi biseduar me organet qendrore të policisë, me organet regjionale të policisë dhe me organet lokale që problemi të zgjidhet përmes policisë. Komuna e Hanit të Elezit e ka një buxhet në të cilin nuk ka planifikuar aktivitet të tillë për çështje të sigurimit dhe për me ndarë mjete për këtë punë nuk kemi mundësi sepse nuk ka rishikim të buxhetit dhe ndoshta mund të kemi ristrukturim të buxhetit. Është e kushtueshme se me dy persona nuk mund të zgjidhet kjo çështje sepse nëse bëhet sigurim duhet së paku të bëhet dymbëdhjetë orë dhe duhet më shumë se dy persona dhe përsëri nuk mund të them që mund të bëhet zgjidhje sepse komuna nuk ka të planifikuar buxhet për aktivitete të tilla.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- idenë që e paraqiti anëtari i asamblesë që këtë çështje me zgjidhur përmes ndonjë kompanie të sigurimit apo me ndonjë kontratë për shërbime të veçanta por duke i shikuar mundësitë ligjore se a na lejohet sepse duhet të shikohet se a është në kompetenca të komunës ajo zonë.

**Habib Thaçi** thekson:- sa i përket çështjes ligjore është mirë me shikuar por me një mirëkuptim të kompanisë “Sharrcem” sepse ata e kanë kompaninë e sigurimeve dhe kamionët e tyre po bllokohen në kolonë dhe te ata nuk është problem nëse i shtonë dy apo tre punëtorë sepse e lehtësojnë punë e tregtisë së tyre.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

## **9. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Habib Thaçi** thekson:- te pjesa e tatimit ndoshta mund të jetë lëshim teknik se keni potencuar që shpenzimet në tatime shënuan vlerën e 3,882.64 € duke shënuar një rritje prej 1009.29 € apo 35.12 % më shumë krahasuar me vitin 2020, duhet ta analizoni dhe nëse është ndonjë lëshim teknik duhet ta përmirësoni. Shpenzimet e rrymës për vitin 2020 janë në shumë prej 404.28 €, ndërsa në vitin 204.36 €. Te këstet tre mujore në ATK për vitin 2020 janë në shumë prej 551.75 €, ndërsa për vitin 2021 janë në shumë prej 377.06€ që do të thotë se nëse rritet numri i punëtorëve rritet edhe pagesa e tatimeve. Kërkoj sqarim për çështjet të cilat i parashtrova.

**Kujtim Dernjani** thekson:- sa i përket kësteve të ATK-ja bëhet fjalë për periudhën gjashtë mujore dhe këtu është shënuar për tre muaj do të thotë se është gabim teknik . Te pjesa e tatimit është gabim teknik sepse duhet të jetë ngritje.

**Sead Vila** thekson:- kompania është duke i kryer punët mirë dhe po shihet se kanë filluar me u vetëdijesuar edhe qytetarët por një përqindje e tyre janë jashtë sistemit, do të ishte mirë që të motivohen edhe këto familje që të hyjnë në sistem. Janë pastruar disa deponi të mbeturinave nëpër vende të ndryshme por ende ka persona që i hedhin mbeturinat por komuna është mirë që përmes inspektoratit të ju shqipton gjoba personave që hedhin mbeturina në vendet e ndaluara

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- sa kamion i ka funksional kompania.

**Kujtim Dernjani** thekson:-për momentin janë tre kamionë, dy traktorë dhe një veturë të vogël për shërbime të kompanisë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

## 10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Habib Thaçi** thekson:- shkolla fillore “Ilaz Thaçi” ka numër të madh të nxënësve që ka shumë paralele dhe tash është regjistrimi i nxënësve në klasën e parë andaj kërkoj nga drejtorja komunale e arsimit dhe nga drejtori i shkollës që pranimit i nxënësve në klasë të parë të bëhet si fillim , e jo duke u caktuar automatikisht te mësuesi sepse ndoshta një mësuesit i ka dal zani që është më i miri por ndoshta në realitet nuk është dhe po i grumbullohen nga 40 nxënës me një klasë , ndërsa arsimtarët e tjerë ndoshta nuk e kanë pasur përkrahjen e personave të tjerë përgjegjës dhe kanë mbetur ma anash. Disa mësimdhënës të tjerë po i kanë 30 nxënës të shkëlqyeshëm , kurse pjesa tjetër po mbesin me nxënës të kategorisë më të dobët e po bëhet një ndarje në mes të nxënësve dhe gara në mes tyre po humbë . Kjo do të ndikon te mësimdhënësit dhe te nxënësit për shkak se sa do që punon me nxënës është problem me arritur një sukses shumë të mirë, ndërsa dikush me nxënës shumë të mirë dhe me shumë pak punë arrin rezultate.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- problem është çështja e ujit për shkak se nuk është tu pasur prej burimit të Dimcës.

**Mallzum Qajani** thekson:- sa i përket ujit i cili vjen nga fshati Dimcë ujë ka por ndoshta nuk ka në sasi të mjaftueshëm , pjesa e ujit të Thartë nuk kanë por po t'i shikon në Han të Elezit të gjithë janë tu vadit dhe a mundesh me shkuar në Lagjen Curri me ndal se edhe ata janë tu vadit dhe nëse shkojmë në Lagjen Curri i themi që me lëshuar uji ata potencojnë që ndale ujin në Han të Elezit mos vaditni dhe ne e lëshojmë uji por ujë keni sepse vjen një gyp 125 cm plotë por derdhet shumë. Ujë në Han të Elezit ka por është problem deri sa të menaxhohet.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

